



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës  
Opstina Kamenica  
Kamenica Municipality



**KOMUNA E KAMENICËS**  
**Zyra e Kryetarit**  
**Nr.02/dt.12/06/2024**  
**K a m e n i c ë.**

## THIRRIJE

Për.....nga.....

Kryetari i Komunës, konform dispozitave në fuqi të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, caktoi mbledhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi e cila do të mbahet më **20/06/2024**, më fillim në ora **14.00h.**

### Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Paraqitja e gjendjes aktuale në komunë. Raport për gjendjen e sigurisë në Komunën e Kamenicë;
3. Fatkeqësitë natyrore, vërshimet, erërat e forta, bllokimi i kanaleve dhe;
4. Mirëmbajtja e gjelbërimit;
5. Të ndryshme

Mbledhja do të mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal në Ndërtesën e Administratës Komunale në Kamenicë.



**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



## PROCESVERBAL

25/04  
I përpiluar më datë 22/03/2024, me fillim në ora 14:00, në sallën e Kuvendit Komunal në Kamenicë. Prezent janë Kryetari i Komunës z. Kadri Rahimaj me anëtarë të KKSBB-së dhe përfaqësues të KFOR-it .

### Rend dite:

1. Paraqitja e gjendjes aktuale në komunë, raport për gjendjen e sigurisë në Kamenicë;
2. Mirëmbajtja e shkollave, siguria në dhe për rreth objekteve shkollore, delikuenca e nxënësve, mbarëvajtja procesit arsimor nga ana e mësimeve;
3. Informatë rreth planit të punës së KKSBB-së për vitin 2024;
4. Të ndryshme.

Mbledhjen e hapi dhe udhëhoqi z. Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës i cili përshëndet të pranishmit dhe i njofton se plani i punës është miratuar nga Kuvendi Komunal dhe për këtë vit është mbledhja e parë, dhe besoj se ky plan të zbatohet për vitin 2024.

### Pika I

Paraqitja e gjendjes aktuale në komunë, raport për gjendjen e sigurisë në Kamenicë;

**Florim Klaiqi, Komandant i Stacionit Policor Kamenicë**, situata e sigurisë është e qetë, shqetësuese është përdorimi i lëndëve narkotike, shqetësuese është, aksidentet në trafik edhe përkundër sanksioneve ju njoftoi se nga 1 prilli hynë rregullat e reja dhe gjobat do të jenë shumë të larta.

**Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës**, qyteti i Kamenicës është i qetë pa ndonjë problem, këtu e kemi Komandantin e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit i cili do të na njoftoi rreth gjendjes së sigurisë.

**Nazif Hajrizi, Komandant i Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit**, situata është e qetë nuk ka ndonjë shqetësim, nuk kemi ndonjë incident kemi kontrollë të vazhdueshme në zonën kufitare.

**Sherefedin Vranja, përfaqësues i OJQ-ve**, i kam disa çështje rreth sigurisë si përdorimi i narkotikëve, shitja e duhanit fëmijëve nën moshën 18 vjeç, mosfunksioni i ndriçimit publik në Ruboc, në rrugën Basri Capolli Kamenicë, dhe eliminimi i qenëve endacak.

**Florim Klaiqi, Komandant i Stacionit Policor Kamenicë**, në qytet janë vendosur kamerat e sigurisë dhe çdo gjë e kemi në kontrollë mund t'i verifikojmë edhe ata vozitës të automjeteve që nuk e kanë rrypin e sigurisë.

**Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës**, shitja e cigareve elektronike është rregulluar me rregulla specifike dhe inspektorët veprojnë brenda kompetencave të tyre. Sa i përket ndriçimit publik jemi në fazën e tenderimit, ndërsa sa i përket qenëve endacak kompania përfituese ata nuk mund të trajtojnë në pranverë.

**Nazmije Demolli Kastrati, Koordinatore e Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut**, i kisha lutë inspektorët e punës të inspektojnë lokalet e gastronomisë dhe lokalet tregëtare është vërejt që punojnë edhe fëmije deri në orët e vona e që punojnë pas orës 12.00 e natës e sidomos në këto lokale është vërejt se kemi fëmijë prej moshës 16 deri 18 vjeç që punojnë me orar të zgjatur dhe pa kontrata.

**Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës**, ne si KKSB, obligojmë koordinatorin që t'i paraqes shkresë Inspektoratit të punës lidhur me këtë shqetësim.

**Aleksandra Popoviq, përfaqësuese e Komunitetit Serb**, përshëndeti të pranishmit, ngriti shqetësimin për familjen Zhivkoviç nga lagja e Kërshlanëve e fshatit Hodonoc e cila disa herë është kërcënuar, a kemi ndonjë informatë rreth kësaj çështje.

**Florim Klaiqi, Komandant i Stacionit Policor Kamenicë**, kemi patrullime të vazhdueshme në këtë anë, nuk muaj me dhënë informata tjera për këtë rast.

#### **Pika II**

Mirëmbajtja e shkollave siguria në dhe për rreth objekteve shkollore, delikuenca e nxënësve, mbarëvajtja procesit arsimor nga ana e mësimitdhënësve;

**Afrim Dervishi, Drejtor në Drejtorinë e Arsimit**, në shkollat e komunës së Kamenicës mësimi është duke u mbajtur me rregull, përveç disa mungesave të nxënësve që e dëmtojnë këtë proces, kjo nuk ka të bëjë me formësimin, e qëllimi final është duke u arritur.

**Hyrmete Morina, Përfaqësues i Komunitetit të Personave me Aftësi të Kufizuara**, e kam një pyetje për drejtorin e arsimit, a ka parapa buxhet për pjerrinat nëpër shkolla.

**Florim Klaiqi, Komandant i Stacionit Policor Kamenicë**, rreth sigurisë nëpër shkolla nuk kemi bashkëpunim dhe organet përkatëse nuk na japin informata

#### **Pika III**

Informatë rreth planit të punës të KKSB-së për vitin 2024;

Kryetari i komunës fjalën ia kaloi koordinatorit të KKSB-së për të informuar rreth planit të punës të KKSB-së.


**Fisnik Kastrati, koordinatori i KKSB-së**, deklaroi, plani i punës i KKSB-së ka për qëllim përmirësimin e sigurisë së qytetarëve duke u kujdesur për problematikat të cilat drejtpërdrejt e prekin jetën e tyre. Plani i punës ofron qartësi në veprim, definon problematikat dhe afatet që do të trajtohen gjatë vitit, paraqet rezultatet e pritura, tregon se kush janë autoritetet përgjegjëse për të marrë masa në zgjidhjen e problemeve

#### **Pika IV**

Të ndryshme;

Nuk pati diskutime nga të pranishmit.

Procesmbajtës:

  
Fisnik Kastrati

Kryetari i Komunës

  
Kadri RAHIMAJ